REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**
**SENATI AKADEMIK**

Nr.1837 prot. Elbasan, më 20.09/.2021

**VENDIM**

**Nr.27 datë 20.09.2021**

**"PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 17 DATË 25.09.2020 PËR HAPJEN E PROGRAMIT TE STUDIMIT MASTER PROFESIONAL NË "MËSUES NDIHMËS NË ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS" NË DEPARTAMENTIN E METODOLOGJISË SË MËSIMDHËNIES, FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT"**

Bazuar në nenin 3, pika 2, germa b; nenin 38, pika 1, germa dh; nenin 75 dhe 83 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Kreu IV/A, pika 3, germa b të Udhëzimit të MASR-së nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" Senati Akademik,

**VENDOSI:**

1. Emërtimi i Vendimit të Senatit Akademik nr. 17 datë 25.09.2020 ndryshohet dhe bëhet: *"Për hapjen e programit te studimit Master në **"Mësuesi për arsimin special"** në Departamentin e Metodologjisë së mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave të Edukimit".*

2. Pika 1 e Vendimit ndryshohet dhe bëhet: *Të miratojë hapjen e programit të studimit me Master në **"Mësuesi për arsimin special"**, në departamentin e Metodologjisë së mësimdhënies, Fakulteti i Shkencave të Edukimit.*

3. Pika 2 e Vendimit ndryshohet dhe bëhet: *Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit **Master në "Mësuesi për arsimin special"** të jetë 2 vjet me 120 kredite.*

4. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për procedura të mëtejshme të miratimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Prof.Dr.Skender TOPI**

Adresa: Rruga "Ismail Zyma", Elbasan, Tel. +355 54 252593, www.uniel.edu.al, info@uniel.edu.al